

Si t'i bëj më të sigurta shërbimet e mia bankare online?

ProCredit Banka është e përkushtuar në atë që t'i bëjë më të sigurta transaksionet tuaja online si edhe ta mbrojë integritetin e të dhënave në llogarinë tuaj bankare. Me qëllim që ta arrijmë këtë, e shfrytëzojmë softuerin më të ri të sigurisë dhe zbatojmë procedura shumë të sigurta. Megjithatë, çdoherë duhet të keni parasysh se Interneti dhe posta elektronike mund të shfrytëzohen si mjetet për aktivitet jolegal. Prandaj, rekomandojmë që të ndërmerri disa masa të thjeshta të kujdesit që të vërtetoheni në sigurinë tuj kur kryeni shërbime bankare online.

Këshilla që të jeni të sigurt kur kryeni shërbime online

Bëhuni të vetëdijshëm me kë keni punë

Çdoherë hyni në shërbimet bankare në Internet me atë që do ta bartni adresën e bankës në: <https://ebank.pcb.com.mk>. Asnjëherë mos hapni faqe interneti nëpërmjet lidhjes në postën elektronike që të bartni informacione personale. Nëse dyshoni, kontaktoni Bankën ProCredit në **02 2446-000**

Mbani fjalëkalimet të sigurta

Çdoherë keni kujdes nga mesazhet e padëshiruara elektronike ose thirrjet të cilat nga ju kërkojnë të zbuloni çfarëdo qoftë të dhëne personale ose numra të kartelave të kredisë! Banka ProCredit ose policia **asnjëherë** nuk do të ju kontaktojnë dhe të kërkojnë t'i zbuloni informatat për fjalëkalimet. Atë informatë ruajeni në fshehtësi. Duhet të jeni të kujdesshëm gjatë zbulimit të të dhënave personale të kujt do qoftë, veçanërisht nëse nuk e njihni atë person.

Mbajeni kompjuterin tuaj të sigurt

Shfrytëzoni softuer të azhurnuar për viruse dhe instaloni mur mbrojtës tuajin. Çdoherë shfrytëzoheni versionin e fundit të kërkuesit të Internetit me të gjitha azhurnimet e sigurisë. Bëhuni të kujdesshëm veçanërisht në internet kafenetë ose bibliotekat ose në cilindo qoftë kompjuter tjetër i cili nuk është prona juaj.

Ruajini paratë tuaja



Mos u mashtroni nga mesazhet elektronike të cilat tingëllojnë si të sigërtë duke ju ofruar mundësi të fitoni para lehtë. Nëse tingëllon shumë mirë që të jetë e vërtetë, me siguri është ashtu. Veçanërisht bëhuni të kujdesshëm me mesazhet e padëshirueshme elektronike nga jashtë vendit – shumë më vështirë është të kontrolloni nëse dërguesit, faktikisht, janë ata që thonë se janë.¹

Për më tepër informata, vizitoni faqe-interneti të specializuara si:
<http://www.staysafeonline.org/stay-safe-online>

Këshilla plotësuese për siguri online

Bëhuni të vetëdijshëm me kë keni punë

- Çdoherë shfrytëzoheni platformën e sigurinë për shërbime e-banking të ProCredit Bankës. Para se të bartni çfarëdo qoftë informate personale, vërtetohuni se në pjesën e poshtme të djalhtë të kërkuesit tuaj është shfaqur dryni i mbyllur ose çelësi i plotë. Kur të vendoset lidhja e sigurt, adresa e internetit të bankës do të ndryshohet nga “http” në “https”.
- Mund ta shihni **certifikatën e sigurisë** në ProCredit Bankë me klikimin e drynit i cili shfaqet në kërkuesin tuaj.



Mbajini fjalëkalimet sigurt

- Fjalëkalimi dhe të gjitha informatat tjera të sigurisë çdoherë mbani përmendsh dhe menjëherë shkatërrojeni lajmërimin i cili përmban informata të tilla.
- Ndërmerrini hapat përkatës për fjalëkalimin tuaj dhe informatat e sigurisë të jenë çdoherë në fshehtësi.
- Nëse paraqiteni në bankë, kini kujdes në atë cilat informata do të kërkohen nga ju. Asnjëherë nuk do ta kërkojnë fjalëkalimin tuaj.
- Vërtetohuni që ç’kyçeni në mënyrë të rregullt pasi të mbaroni me shërbimet bankare online.

¹ Ju lutemi shiheni dokumentin “Si të mbrohem nga vjedhja e identitetit?”

- Asnjëherë mos e rruani fjalëkalimin në kompjuterin tuaj, përveç nëse nuk është i mbrojtur (p. sh. menaxhues fjalëkalimesh (*passwordmanager*)).
- Asnjëherë mos e lini kompjuterin tuaj pa mbikëqyrje kur jeni të kyçur në shërbimet bankare në internet.
- Ju rekomandojmë rregullisht ta ndryshoni fjalëkalimin. Nëse e ndryshoni fjalëkalimin, zgjidhni ndonjë që nuk është i lehtë të qëllohet.
- Mos e shfrytëzoni fjalëkalimin tuaj për shërbimet bankare online në faqe të tjera të internetit.

Mbajeni kompjuterin tuaj të sigurt

- Bëhuni të kujdesshëm me të gjitha mesazhet e padëshirueshme elektronike (veçanërisht ata nga dërguesit e panjohur) dhe asnjëherë mos klikoni në lidhje me mesazhe të tilla elektronike me qëllim që të vizitoni faqe interneti të panjohura.
- Mos hapni, mos pranoni ose mos bëni bashkëngjitje të mesazheve elektronike nga burime të panjohura, të dyshimta ose të pabesueshme.
- Instaloni softuer anti-virus, azhurnojeni dhe rregullisht bëni skenim sigurie. Instalojini azhurnimet e fundit të sigurisë, gjithashtu të njohura si *patches*.

Mos u bëni plotësisht të besueshëm për çfarëdo ndryshimi në rutinën tuaj të zakonshme për shërbime bankare në internet. Nëse keni çfarëdo dyshimi, ju lutemi kontaktojeni Bankën ProCredit duke e vizituar degën më të afërt, ose kontaktojeni Këshilltarin tuaj të Klientëve ose thirrni në linjën tonë për ndihmë në 02 2446-000.